

VENDIM
Nr. 254, datë 9.5.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 58, DATË 21.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN E DISA FAMILJEVE QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “LIDHJA E RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME SUPERSTRADËN FIER-VLORË” ME PROGRAME SOCIALE TË STREHIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 30 e 33, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 58, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1, fjalët “... përfitojnë nga programi social i strehimit pagesën e qirasë për një periudhë trevjeçare ...”, zëvendësohen me “... përfitojnë nga programi social i strehimit pagesën e qirasë deri në sistemimin me strehim në një nga programet që parashikon ligji për strehimin ...”.

b) Pas pikës 1 shtohen pikat 1.1. dhe 1.2, me këtë përmbajtje:

“1.1 Financimi i qirasë për familjet përfituese për vitin 2018 të mbulohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave. Për periudhën në vijim, financimi i nevojshëm të mbulohet 50% nga buxheti i shtetit që akordohet për strehimin, dhe 50% nga buxheti i Bashkisë Vlorë.

1.2 Financimi i qirasë të bëhet pas verifikimit nga Bashkia Vlorë të gjendjes ekonomike dhe sociale të familjes, sipas parashikimeve të ligjit për strehimin.”.

c) Kudo në përmbajtjen e vendimit, emërtimi “Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit” zëvendësohet me “ministria përgjegjëse për strehimin”.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për strehimin dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama